

“ Nga Fakulteti Ekonomik kanë diplomuar mbi 13 000 studentë. Shumica prej tyre kanë karriera të suksesshme në biznes dhe organizata tjera, në pozita të rëndësishme apo edhe si themelues të tyre. ”

Fakulteti Ekonomik ka vend për ty!

Pranimet

Pranimet në Universitetin e Prishtinës bëhen nëpërmjet konkurseve publike. Çdo person i cili e ka përfunduar maturën shtetërore dhe i përmbush kriteret e përcaktuara në konkursin për studentë të rinj, ka të drejtë të konkurrojë për t'u bërë pjesë e Universitetit tonë.



Rreth nesh

Fakulteti Ekonomik është institucion i përkushtuar në përgatitjen e individëve të shquar për marrjen e roleve udhëheqëse në komunitet, përmes mësimi, kërkimit dhe praktikës në fushën e ekonomisë.

Fakulteti Ekonomik është njësi më e madhe akademike në Universitetin e Prishtinës. Çdo vit, ne pranojmë mijëra aplikime për të studiuar në njërin nga gjashtë programet e studimit: Banka dhe Financa; Menaxhment; Marketing; Ekonomiks; Kontabilitet apo Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhim.



Kontakti

Adresa:

Rr. "Agim Ramadani", p.n. 10 000
Prishtinë, Republika e Kosovës

Telefoni:

+381(0)38 221 895/ 228 966

Email:

ekonomiku@uni-pr.edu

Webfaqja

<https://ekonomiku.uni-pr.edu/>



Fakulteti Ekonomik

Kalendari akademik

| | |
|----------------------|---|
| 15 janar | Përfundimi i ligjëratave (semestri dimëror) |
| 15 janar – 15 shkurt | Provimet e semestrit dimëror |
| 15 shkurt | Dita e Universitetit të Prishtinës |
| 16 shkurt | Fillimi i semestrit veror |
| 31 maj | Përfundimi i ligjëratave për vit akademik |
| Korrik | Konkursi për studimet bachelor |
| Shtator | Konkursi për studimet master |
| 15 shtator | Përfundimi i vitit akademik |
| 1 tetor | Fillimi i vitit akademik |



Programet:

Bachelor

Banka dhe Financa
Menaxhment
Marketing
Ekonomiks
Kontabilitet
Applied Economics and Management

Master

Banka dhe Financa
Menaxhmet
Marketing
Ekonomiks
Kontabilitet

Pse n'Ekonomik?

- Njësia më e madhe akademike e Universitetit të Prishtinës;
- Studentët dhe të diplomuarit më të kërkuar në tregun e punës. Nga pozitat e hapura në portalet e punës, 19,42 % e tyre kërkojnë specializime të Ekonomikut;
- Mundësitë më të shumta për mobilitete (studime njësemestrale) në universitete evropiane;
- Fakulteti me numrin më të madh të studentëve;
- Staf akademik me më së shumti punime shkencore (968) dhe citime (5503) nga fakultetet ekonomike në universitetet publike dhe kolegjet private në Kosovë;
- Diplomë që njihet ndërkombëtarisht;
- Programe atraktive dhe me mundësi punësimi;
- Tarifa të uleta studimi;
- Kampus atraktiv - në qendër të kryeqytetit;
- Profesorë me përvojë dhe eminentë në fushat përkatëse;
- Bursa për studentët me arritje të larta.

